



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 314, Datë 06.12.2022

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS NR. 395 SERIA F18
TË SHOQËRISË “ENERGJI ASHTA” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E
FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE,**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37 pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5 pika 1, gërma “a” dhe nenit 16 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, i ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a”, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 06.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2026 prot., datë 02.12.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “ENERGJI ASHTA” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “ENERGJI ASHTA” sh.a. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1841/1 prot., datë 24.11.2022, ka paraqitur kërkesën për rinovimin e licencës së veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, aplikuesi për rinovimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e kërkuar nga neni 16 “Rinovimi i licencës”; formatin e plotësuar të aplikimit, sipas Shtojcës 1 (neni 16, gërma “a”); çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike apo dokumentacionit tjetër të depozituar në aplikimin për pajisje me licencë (neni 16, gërma “b”); informacion mbi ushtrimin e veprimtarisë e licencuar (kontrata për shitblerjen e energjisë, nëse ka pasur) (neni 16, gërma “c”) Shtojca 1.I; Të ketë kryer pagesën e aplikimit dhe atë të rregullimit në ERE (neni 16, pika 7).
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë nga ERE, në zbatim të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin,

transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar. Po ashtu shoqëria nuk rezulton debitore e pagesave të rregullimit ndaj ERE-s.

- Nga aplikimi i paraqitur nga shoqëria “ENERGJI ASHTA” sh.a. rezulton se është pa plotësuar sa vijon:
Neni 16, pika 1, gërmat “b” dhe “c” (Shtojca 1.I)
 - **Gërma “b” Pa plotësuar**
Shoqëria duhet të na informojë nëse ka pësuar ndryshime apo modifikime të mundshme të dokumentacionit të të dhënave teknike të depozituar në aplikimin për licencë.
 - **Gërma “c” Plotësuar pjesërisht**
Duke qenë se shoqëria nuk ka përcjellë informacion, dhe sa rezulton nga të dhënat që ERE disponon, nuk e ka ushtruar veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, në vijim do t’i kërkohet të përcjelli këtë deklaratë në ERE.
- Për dokumentacionin e munguar do të njoftohet shoqëria që ta përcjellë brenda afateve të përcaktuara nga ERE.
- Në kuadër të plotësimit nga Aplikuesi të dokumentacionit thelbësor sipas kërkesave të rregullores, vlerësohet fillimi i procedurës për këtë aplikim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 395 Seria F18 të shoqërisë “ENERGJI ASHTA” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI